

V E N D I M
Nr.71, datë 11.2.1999

PËR MËNYRËN E LICENCIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCIVE PRIVATE TË PUNËSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 19 të ligjit nr.7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës të Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e veprimtarisë së Agjencive Private të Punësimit (në vazhdim APP).
2. APP-ja funksionon si person fizik ose juridik, privat, që ofron shërbimet e tregut të punës.
3. APP-ja siguron:
 - shërbime, që bjnë vlerësimin e kërkesave dhe të aplikimeve për punësim, brenda dhe jashtë shtetit;
 - shërbime, që lidhen me kërkimin e punës
 - shërbime për punësimin e punëtorëve, për t’u bërë të disponueshëm për një palë të tretë, person fizik ose juridik, i cili cakton detyra dhe kontrollon zbatimin e tyre.
4. Në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale ngrihet komisioni i licencimit, i përbërë nga:
 - Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale(kryetar)
 - Inspektori i Përgjithshëm i ISHP-së(anëtar)
 - Drejtori i Përgjithshëm i SHKP-së(anëtar)
 - Drejtori i Drejtorisë së Emigraiconit(anëtar)
 - specialist, jurist(anëtar)
5. Komisioni i licencimit, pasi bën vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur prej subjekteve të interesuara, vendos licencimin ose jo të tyre.
6. Dokumentet e nevojshme, që duhet të paraqiten për licencim, janë:
 - Kërkesë me shkrim për licencim.
 - Pasaportë (fotokopje e noterizuar), 4 copë fotografi dhe, për personat juridikë, akti regjistrimit në gjykatë.
 - Dëshmi penaliteti.
 - Përshkrimi i veprimtarisë së personit juridik.
 - Përshkrim i degëve të ekonomisë ose veprimtarive ekonomike, ku synon të zhvillohet veprimtaria e APP-së.
7. Për marrjen e licencës paguhet një tarifë prej 150 000 (njëqindpesëdhjetë mijë) lekë.
8. Komisioni i licencimit mund të mos pranojë licencimin e APP-së për kategori të caktuara punëtorësh ose degë të ndryshme të veprimtarisë ekonomike, me vendim të argumentuar, në bazë të rrethanave specifike që mund të krijohen ose në mbrojtje të interesave të punëtorëve.
9. Kundër vendimit të mospranimit mund të bëhet ankim në gjykatë.
10. APP-ja duhet të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë punëtorët, pa dallime raciale, seksi, besimi fetar, pikëpamjeje politike.
11. APP-ja nuk mund të ofrojë shërbimet e veta për të miturit.
12. Punëtorët e rekrutuar nga APP-ja gëzojnë të drejta për negociim kolektiv, lirinë e asociimit, pagën minimale, kohën dhe kushtet e punës, përfitimet e sigurimeve shoqërore, mbrojtjen e sigurisë dhe të shëndetit në punë.
13. APP-ja duhet të njoftojë punëtorët për kushtet e punës përpara fillimit të punës.
14. Përpunimi i të dhënave të punëtorëve nga APP-ja bëhet duke respektuar konfidencialitetin dhe përdorimin e të dhënave, sipas natyrës së punës.
15. APP-ja, për punësimet jashtë shtetit të shtetasve shqiptarë, zbaton të gjitha marrëveshjet dypalëshe të Qeverisë Shqiptare me vendet përkatëse.
16. APP-ja, një herë në vit, njofton Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale për strukturën dhe veprimtarinë e saj.
17. APP-ja duhet të shkëmbejë, rregullisht, informacione me Agjencitë Publike të Punësimit.

18. Komisioni i licencimit kur vëren:

-shkelje të parimit të barazisë;

- mospërbushje të detyrimeve për sigurimet shoqërore, kontratat e punës, negociimet kolektive, sigurimin dhe mbrojtjen në punë, kompensimin në raste aksidenti ose sëmundjeje;

-publike të përsëritura mashtruese,

me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Punës, organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, si dhe të subjekteve të tjera të interesuara, mund të ndalojë veprimtarinë e APP-së.

19. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për të nxjerrë udhëzimin përkatës për përcaktimin e tarifave të shërbimeve të ofruara nga APP-ja.

20. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.606, datë 30.10.1995 “Për dhënien e lejes për ndërmjetësimin për punësim dhe kualifikim, nëpërmjet punësimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të shtetasve shqiptarë” shfuqizohet.

21. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko